



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 803/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Avduli” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-31025-10-24-2017, me objekt “*Rehabilitim i kanalit ujitës, fshati Plug*”, me fond limit limit 12,108,193 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnjë.
- Ankimues:** Operatori Ekonomik “Avduli” sh.p.k.
Adresa: Lagjia “10 Korriku” Rruga “Perlat Rexhepi”, objekt 3-katësh, Nr. 4, Kati I, Vlorë.
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Lushnje
Adresa: Lagjia “Gafurr Muço”, Lushnjë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.10.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-31025-10-24-2017, me objekt “*Rehabilitim i kanalit ujitës, fshati Plug*”, me fond limit limit 12.108.193 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnjë”.

II.2. Në datën 17.11.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 23.11.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Avduli” sh.p.k.	8,235,377 lekë pa tvsh,	skualifikuar
2. “Bean” sh.p.k.	8,349,197 lekë pa tvsh,	skualifikuar
3. “Elira” sh.p.k.	8,890,527 lekë pa tvsh,	skualifikuar
4. “Glavenica” sh.p.k.	9,272,696 lekë pa tvsh,	kualifikuar
5. “Sark ” sh.p.k.	9,634,512.5 lekë, pa tvsh	kualifikuar
6. “Fled” sh.p.k.	9,648,496 lekë pa tvsh,	kualifikuar
7. “Sireta 2F” sh.p.k.	10,000,000 lekë pa tvsh,	kualifikuar
8. “Hastoci” sh.p.k.	10,926,423 lekë pa tvsh,	kualifikuar
9. “Llazo” sh.p.k.	11,036,982 lekë pa tvsh,	kualifikuar
10. “Senka” sh.p.k.	11,313,797 lekë pa tvsh,	kualifikuar
11. “Alfat” sh.p.k.	11,544,794 lekë pa tvsh,	skualifikuar
12. “Ndregjoni” sh.p.k.	11,934,394 lekë pa tvsh,	kualifikuar

II.4. Në datën 23.11.2017 operatori ekonomik ankimues ”Avduli” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

- *“Sipas QKB ka patur adrese biznesi ne Tirane dhe Gjirokaster { Tepelene } per vitin 2017 dhe i ka mbyllur po brenda vitit 2017 nuk ka paraqitur vertetim nga OSHEE per keto adresa biznesi. Ekskavatore me goma nuk nje manovrator.”*

II.5. Në datën 30.11.2017 operatori ekonomik ankimues ”Avduli” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Pra kemi paraqitur ne kete procedure prokurimin vertetimin e debise me Nr.5882 Prot. date 14.11.2017, i cili verteton se subjekti Avduli shpk nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt OSHEE-se. per sa i perket adresave sekondare te regjistruara ne Ekstrakt Historik kemi ushtruar aktivitet per pak kohe por ne asnje moment nuk kemi pasur kontrate te lidhur me OSHEE-ne, per adresat dytesore qe ju keni permendur si arsye skualifikimi. Ne momentin qe shoqeria Avduli nuk ka deklaruar kontrata nuk ka se si te paraqese vertetim per keto dy adresa dytesore [Tirane, Gjirokaster(Tepelene)] nuk eshte perdorur energji elektrike e per pasoje shoqeria nuk kishte arsye te lidhte dhe te deklaronte kontrata me OSHEE-ne. Ne momentin qe ne si subjekt nuk kemi deklaruar kontrata per keto adresa dytesore nuk kemi se si te paraqesim vertetim. Vertetimi qe ne kemi paraqitur ne kete procedure prokurimi eshte nje vertetim qe konfirmon se subjekti Avduli shpk nuk ka as nje lloj detyrimi kundrejt OSHEE-se e per pasoje cdo pretendim i ngritur nga KVO eshte pa asnje baze ligjore, dashakeqes dhe tregon njeanshmeri te KVO-se.

Referuar sa me siper rezulton te kerkesat per kualifikim ne lidhje me vertetimin e OSHEE-se eshte permbushur nga shoqeria Avduli shpk e cila nuk rezulton debitore kundrejt OSHEE-se, e ne keto kushte pretendimi i KVO-se nuk qendron. Gjithashtu duam te sjellim ne vemendje te KVO-se qe adresat dytesore qe ju keni permendur ne arsyet e skualifikimit [Tirane, Gjirokaster(Tepelene)] jane dy adresa dytesore te mbyllura nga shoqeria Avduli shpk para disa muajsh e ne keto kushte

edhe po te kishim deklaruar kontrata me OSHEE-ne perseri nuk do mund te paraqesnim vertetim pasi behet fjale per adresa te mbyllura per Tiranen ne 31.03.2017 dhe per adresen Gjirokaster(Tepelene) ne 10.10.2017. Ne momentin qe nuk kemi deklaruar kontrata me OSHEE-ne eshte absurditet te kerkohet vertetim nga ana juaj per keto adresa.

Lidhur me pretendimin e dyte, ne lidhje me manovratoret ju sqarojme se:

Ne kerkesat per kualifikim keni kerkuar: "Eskavatoret duhet te jene te pajisur me manovrator me patenten perkatese te mjetit" Per te plotesuar kete kriter shoqeria Avduli ka paraqitur ne kete procedur prokurimi manovratoret dhe drejtues mjete per makinerit te renda te paisur me kontrate pune, leje drejtimi, certifikat te aftesise profesionale si dhe deshmi kualifikimi e sigurimit teknik :

1.Golik Taraj

2.Virion Canaliaj

3.Josif Gjondedaj

4.Illir Kenella

Sipas certifikatave te deshmise profesionale perkatese vertetohet aftesia per te drejtuar makineri dhe paisje te renda te tipit kamion, autobetonjere, mjete germimi etj, pasi te gjithë keta drejtues zoterojne piken "C" qe verteton aftesine per te drejtuar eskavatoret e nevojshem per proceduren ne fjale.[...]"

II.6. Në datën 04.12.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 231 prot., datë 04.12.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke pranuar pjesërisht ankesën si më poshtë:

"a) "Ka te drejte per pretendimin ne lidhje me manovratoret pasi ne sistem jane te paraqiture te katert manovratoret, te cilet jane te pajisur me kontrate pune, leje drejtimi, certifikate te aftesise profesionale si dhe deshmi kualifikimi dhe sigurimi teknik.,

b.)Nuk ka te drejte ne lidhje me pretendimin per vertetimin per shlyerjen e detyrimeve te OSHEE-se pasi shoqeria duhet te kishte paraqitur dhe per keto dy pika biznesi vertetimin qe konfirmonte shlyerjen e detyrimeve ose te paraqiste vertetimin qe nuk ka pasur asnje kontrate me OSHEE-ne ne keto dy pika biznesi te hapura dhe te mbyllura brenda vitit 2017."

II.7. Në datën 07.12.2017 operatorit ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.8.Në datën 15.12.2017, nëpërmjet shkresës me nr.242 prot., datë 13.12.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Avduli" sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Avduli” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit “*Sipas QKB ka patur adrese biznesi ne Tirane dhe Gjirokaster { Tepelene } per vitin 2017 dhe i ka mbyllur po brenda vitit 2017 nuk ka paraqitur vertetim nga OSHE per keto adresa biznesi*” nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, shtojca 10, pika 2.1.e “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar: “*e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*”

III.1.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

1.Vërtetimin nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me Nr. 5882 Prot, datë 14.11.2017, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në RSH në të cilin thuhet se: “*Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) Z.Arben Avduli vërtetohet se kërkuesi "Avduli SHPK" nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) FIOA020013004042, titullar i te ciles është: Avduli shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 13.11.2017, duke përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2017*”

III.1.3 Në Nenin 27, pika 5, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: *[...]Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastiit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.*”

III.1.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

III.1.5. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë: 7 “[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).
2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.
3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

- 1.Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.
- 2.Konsumatori rezulton debitor.
- 3.Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.
- 4.Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.
- 5.Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]”

Gjithashtu referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 30.03.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 6287/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, në të cilin dorëzohet një kopje e formatit standard të lëshimit të vërtetimit të debisë nga ku rezulton se është si më poshtë vijon: “[...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. _____ vërtetojmë se kërkuesi _____ nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratat (me kod)

_____, titular i së cilës/cilavë është _____ rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e përlllogaritur deri në datën _____._____._____ pa përfshirë faturën koherente të muajit _____ [....]

III.1.6. Referuar vërtetimit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.P.P. konstaton se OSHEE Sh.a shprehet se “nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) FIOA020013004042, titullar i te ciles është: Avduli shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 13.11.2017, duke përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2017”, në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 8 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 109 datë 21.10.2011 të ERE “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.” Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k. ka dorëzuar vërtetim lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sipas formatit standard të vërtetimit të lëshuar nga OSHEE Sh.a. në të cilën pasqyrohet se shoqëria “Avduli” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera të energjisë elektrike deri më datën 13.11.2017 përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2017. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ka dorëzuar në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe parashikimeve të aktit normative në zbatim të ligjit vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjithë detyrimeve në vendet e ushtrimit të aktivitetit lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a, sipas formatit standard të miratuar nga ky i fundit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ankimes “Avduli” sh.p.k. qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-31025-10-24-2017, me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës, fshati Plug”, me fond limit limit 12,108,193 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnjë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Avduli” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1800 Protokoli Datë 07.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

